



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 645/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj, kryesuese e panelit, Afijete Sada – Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelet e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gëzim Dervishaj nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të paraqitura kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me rezultatin përfundimtar të publikuar me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e Panelit, të mbajtur më datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara apelet Anr.645/2021 dhe Anr.646/2021 të datës 05.03.2021 i paraqitur nga Gëzim Dervishaj kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave.

A R S Y E T I M

PZAP-i, me datën 04.03.2021 ka pranuar dy apele Anr.645/2021 dhe Anr.646/2021 nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gëzim Dervishaj nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se në bazë të informatave të sigurta nga familjaret e tij të cilët e kanë votuar atë ka pasur parregullsi në numërimin dhe bartjen e votave të tij në raportin përfundimtar FRP. Parashtruesi i apelit pretendon se këto parregullsi kanë ndodhur në këto vendvotimet 3101C/06R, 3101C/05R, 3101C/04R, 3101C/03R, 3101C/02R, 3101C/01R, 0103C/03R, 0103C/02R, 0103C/01R, 0108C/05R, 0108C/04R, 0108C/03R, 0108C/02R, 0108C/01R, 0107C/01R, 0107C/02R.

I njëjti kërkon që të aprovohet apeli i tij dhe që të behet rinumërimi i votave në këto vendvotime,

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, i ka bashkuar apelet e lartcekura dhe të njëjtat i trajton si një apel, të evidentuar me Anr.645/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve për çka të gjitha i vendosi me një vendim për hire të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, me rastin e shqyrtimit të pretendimeve ankimore, provave që gjinden në shkresat e lëndëve, materialin zgjedhor dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Paneli, pasi që shqyrtoj apelet vlerësoi se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete lidhur me atë se çfarë është pretenduar në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Gëzim Dervishaj nga subjektit politik AAK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 645/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.